

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju informojmë se:

OSHMA-të TV Saranda, Tv 4 Plus, TV Gold dhe TV Klaudiana nuk depozituan në AMA më datë 20.04.2021 regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të një dite më parë. AMA rikujton këto OSHMA, por dhe të tjera, të njoftuara në mënyrë të përsëritur, me shkresë zyrtare dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta, se duhet që të zbatojnë sistematikisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ. Përmbajtjet e regjistruara duhet të depozitohen në AMA brenda orës 10:00 të ditës së nesërme të transmetimit.

Gjatë transmetimeve të datës 19.04.2021, nga ora 21:00 deri në 21:51, OSHMA Syri TV ka pasur në fokus gjetjet e një sondazhi zgjedhor. AMA ka konstatuar se nuk janë dhënë gjatë transmetimit koha e zhvillimit të sondazhit si dhe probabiliteti i gabimit, ndër kërkesat e detyrueshme për t'u bërë publike, sipas nenit 78 të Kodit Zgjedhor.

TV Bulqiza edhe më datë 19.04.2021 në ora 15:00 ka transmetuar, edicionin informativ të një OSHMA-je tjetër. Subjekti ka marrë njoftime nga AMA që ta ndërpresë një praktikë të tillë.

Kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

TV News 24 18:02; 18:04; 18:05; 18:06; 18:08; 18:09.

TV Shijak 18:36; 19:58; 20:45.

TV Channel 1 08:39; 09:15; 10:00; 11:42; 12:22; 14:40; 18:34; 19:50; 20:00.

Kanë transmetuar reklama politike brenda edicionit të lajmeve OSHMA-të:

TV Klan News 15:09; 15:20; 16:02; 16:22; 16:30; 17:20; 21:47; 21:57; 22:17; 22:39;
22:47; 23:12; 23:28; 23:44.

TV Channel 1 15:32; 18:34; 20:00; 22:27.

RE.AI 17:13; 17:19.

Në transmetimet e datës 19.04.2021 (prej orës 08:00 – 24:00) OSHMA TV Channel 1 ka vendosur logon e një subjekti politik shoqëruar me fjalë për të votuar pro tij në zgjedhjet e 25 prillit. OSHMA-ja duhet ta ndërpresë një praktikë të tillë të reklamës politike dhe të respektojë kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet nga monitorimi për transmetimet e datës 19.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 20.04.2021